

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
STUDIME POSTDIPLOMIKE-MASTER**

DREJTIMI FINANCIAR



Tema:

A janë Bankat Qendrore në shtetet ballkanike të pavarura nga ekzekutivi ?

(Aspektet krahasuese)

Mentori:

Prof.Dr. Bedri Peci

Kandidatja:

Donika Bekteshi

Janar 2023

ABSTRAKTI

Synimi i këtij punimi master është që të trajtoj mënyrën e funksionimit të punës së bankave qendrore të vendeve ballkanike nga këndvështrimi i pavarësisë së tyre - nga ekzekutivi.

Në kudër të këtij vështrimi po ashtu punimi nxjerr ne pah edhe aspektet krahasuese të bankave qëndrore të vendeve ballkanike.

Gjatë shtjellimit të punimit do të flitet për fillet e para të Bankave Qendrore ku do të shpalosen definicionet e ndryshme mbi bankat e po ashtu e në veqanti për Bankat Qendrore, do të elaborohet krijimi i bankave qendrore dhe zhvillimi i tyre, funksioni dhe roli i bankave qendrore, punët e bankave qendrore, politika monetare dhe kreditore e bankave qendrore.

Posaqërisht do të specifikohet pavarësia e bankave qendrore nga ekzekutivi (bankave qendrore të vendeve ballkanike), organet vendimarrëse dhe menaxhuese të bankave qendrore, politika monetare dhe kreditore, objektivi parësorë i tyre, funksioni dhe detyrat e bankave qendrore.

Po ashtu, do të shtjellohen aspektet krahasuese të bankave qendrore të këtyre vendeve (ballkanike), autorizimet mbikqyrëse dhe rregulluese , llogaridhënia – bankat qendrore i përgjigjen vetëm Kuvendit të vendeve përkatëse.

Me theks të veqant do të pasqyrohen aspektet krahasuese të bankave qendrore, strukturave udhëheqëse dhe menaxhuese, politika monetare dhe kreditore, autorizimet mbikqyrëse dhe rregulluese , pra do të pasqyrohen ngjajshmërit dhe dallimet në mes të këtyre bankave qendrore.

Si përfundim, në mënyrë më të detajuar do të paraqesim aspektet krahasuese të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Republikës së Shqipërisë.